



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) dhe nenit 17, pika k) e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, nenit 14, paragrafi 6 dhe nenit 29, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-084, për mbrojtjen e fëmijës, nenit 22, paragrafët 1 dhe 8 të Ligjit nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare, si dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.3.2025, merr këtë:

V E N D I M

PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR FAMILJET STREHUESE DHE FËMIJËT NË STREHIM FAMILJAR

Neni 1 Qëllimi

1. Miratohet Vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar.
2. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i ndihmës financiare për përkujdesjen dhe mbështetjen e ofruar nga familjet strehuese për fëmijët.

Neni 2 Komponentët e ndihmës

1. Subvencionimi i familjeve strehuese, në shumë prej 300 euro në muaj.
2. Subvencionimi i fëmijëve në strehim familjar në shumë prej 300 euro në muaj për fëmijë.
3. Subvencionimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar në strehim familjar në shumë prej 375 euro në muaj për fëmijë.

4. Subvencionimi i familjeve strehuese në gatishmëri për strehim të fëmijëve në shumë 225 euro në muaj.

5. Subvencionimi i personave që arrijnë moshën 18 vjeç, që nuk kanë zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë, e që janë në strehim familjar, mbështetet me 675 euro në muaj.

Neni 3

Procedura për përkrahje

1. Procedura për përkrahje financiare iniciohet nga menaxheri i rastit në Qendrën për Punë Sociale (QPS) në Prishtinë.

2. QPS bashkëpunon me organet relevante për të vlerësuar dhe aprovuar përfitimin e ndihmës financiare.

Neni 4

Afatet dhe monitorimi

1. Kjo ndihmë financiare mund të ofrohet për një periudhë deri në 12 muaj, me mundësi vazhdimi sipas vlerësimeve të QPS.

2. Monitorimi i zbatimit të këtij vendimi bëhet nga QPS dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe organet tjera relevante.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-450/03-45628/25, më 2.4.2025

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupa

